

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, përmes gjyqtares Mevlide Shabani, me bashkëpunëtorën profesionale Vlora Selmani – Rahimi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore me objekt kontesti, kompenzimi i pagave pas pensionimit, sipas padisë së paditësit Sh. Sh. nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit në Gjilan ,të cilën e përfaqëson Arben Mehmeti, në seancën gjyqësore dhe publike të datës 24.01.2017, bie këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh. Sh. nga Gjilani, e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Gjilanit Drejtoria Komunale Arsimit në Gjilan, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura ti ja paguajë në emër të përcjelljes në pension ,2 paga në vlerë prej 825.26€, ne emër te shpërblimit jubilar 2 paga ne vlerë prej 825.26€,dhe ne emër të regresit shumen prej 120 € për shpërblim jubilar të gjitha në vlerë prej 1.770euro €, me kamatë ligjore 3.2 %, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit , nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm .

II.Secila palë i përballon shpenzimet e saj të procedurës.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Paditësi, Sh. Sh. nga Gjilani më date 02.10.2013, ka ushtruar padi për kompenzimin e pagave pas pensionimit, kundër të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura ti ja paguajë regresin në shumë prej 120 euro, për shpërblim jubilar dy paga në vlerë prej 825.26 €, për përcjellje në pension dy paga në vlerë prej 825.26€, të gjitha në vlerë prej 1.770euro €, me kamatë ligjore 3.2 %, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit , nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Pas pranimit të padisë , kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur i ka dërguar padinë, në mënyrë që e njëjta të paraqesë përgjigje lidhur me pretendimet e saj, njëkohësisht duke e paralajmëruar të padituren, që nëse brenda afatit të paraparë ligjor nuk përgjigjet gjykata do të merr aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë-mosbindjes, të cilën paditësi e ka kundërshtuar në tërësi.

2.Pretendimet e palëve ndërgjyjëse

Paditësi Sh. Sh. nga Gjilani në seancën kryesore, të datës 24.01.2017 si dhe në fjalën përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke kërkuar që kërkesëpadia të aprovohet në tërësi.

I autorizuari të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, në seancën e shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se paditësi duke u bazuar në kontratën e mëparshme kolektive përkatësisht në nenin 42,43 dhe 44 e cila ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2005, deri në vitin 2008, ndërsa pas asaj periudhe nuk kanë pasur asnjë veprim të institucioneve relevante dhe se kontrata e përgjithshme kolektive nuk paraqet bazë për në rastin konkret, për arsye se nuk mund të veproj në mënyrë retroaktive, në fund ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazuar.

3.Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata ka lexuar - dhe administruar këto prova:

- Leximin e aktvendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nr.05-962-13, të datës 01.10.2013, të lëshuar nga Drejtoria e Arsimit në Gjilan.*
- Leximin e kërkesës për pagesën e pagave pas pensionimit, drejtuar Drejtorisë së Arsimit në Gjilan, me numër protokoli Nr.963, të datës 01.10.2013, nga ana e ushtruesit të kërkesës në emër të paditësit Sh. Sh. (origjinal).*
- Leximin e përgjegjës në kërkesë të lëshuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit, me numër protokoli 05.Nr.963/2013, të datës 01.10.2013.*

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyjëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, nga të cilat ka gjetur se kërkesëpadia është e pa bazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet.

4.Vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatës

Në bazë të aktvendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës Nr.05-962-13, të datës 01.10.2013 e lëshuar nga Drejtoria Komuna e Arsimit në Gjilan, është konstatuar se paditësi Sh. Sh., ka qenë nënpunës zyrtar i arsimit në kuadër të Drejtorisë së Arsimit në Gjilan deri më datë 26.09.2013, kur i njejtë është pensionuar.

Poashtu gjykata lidhur me kërkesën e paditësit Sh. Sh. ka konstatuar se i njejtë i ka parashtruar kërkesë Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjilan, lidhur me kërkesën për pagesën e pagave pas pensionimi sipas kontratës kolektive, ku ka theksuar shumën e të hollave që kërkon si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Me përgjegjen në kërkesë të lëshuar nga Drejtoria Komunale e

Arsimit në Gjilan, është konstatuar se kontrata kolektive për shkak të implikimeve buxhetore nga Drejtoria e Arsimit, por edhe nga Institucionet tjera nuk është e aplikuar asnjëherë përveç rasteve të lehonisë.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqjese dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, nga të cilat ka gjetur se kërkesëpadija është e pa bazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet, për shkak se paditësi e bazon kërkesëpadijën në kontratën e përgjithshme kolektive të Kosovës e cila ka hyrë në fuqi në Janar të vitit 2005, ndërsa e njëjta kontratë nuk ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi është pensionuar, fakt i vërtetuar në bazë të aktvendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të lëshuar nga Drejtoria e Arsimit në Gjilan me numër të protokollit Nr.05-962-13, të datës 01.10.2013.

Deri te ky konstatim gjykata erdhi duke u bazuar në provat personale dhe materiale në shkresat e lëndës e të cilat nuk vërtetuan gjendjen ekzistuese faktike sikurse paditësi e ka paraqitur në padi.

Gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale, konform nenit 450 të LPK-ës, duke pas parasysh epilogun e kësaj çështje.

Nga të lartëcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në të thënat më lartë e në pajtim nenin 143 të LPK-së, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.720/13, më datë 24.01.2017

Gjyqtarja,
Mevlide Shabani

Këshilla juridike : *Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate .*

*GNga dëgjimi i palëve ndergjyqëse , gjykata vërtetoi faktin se në bazë të Ligjit të Punës nr .03 L-212 , i cili ka hyrë në fuqi me **16.12.2010** , përcakton se në rastin konkret gjykata ka vlerësuar se padia e paditësit është paraqitur pas afatit ligjor të paraparë me nenin 79 të Ligjit të punës ku thuhet se „çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente,,e që paditësi në rastin konkret ankesë kundër aktvendimit nr.04-252 të datës 14.03.2013 , nuk ka paraqitur ankesë por ankesën e ka paraqitur përfaqësuesi i tij me datë 11.06.2014 , si dhe me datë 12.08.2014 , e qka mund të vërtetohet se ankesa e ka paraqitur me date 12.08.2014,ndërsa padinë e paditesit në gjykatë*

e ka paraqitur me date 22.10.2014 , qka nënkuptojmë se nuk është paraqitur padia ne afatin e lejuar ligjor për mbrojtjen gjyqësore të punësuarit.

5.2. Nga provat tjera materiale janë shtjelluar edhe arsyetimet e paditësit sa i përket vendimit për ndërprerjen e mardhënies së punës, se është hera e pare e tij që e sheh vendimin e tillë,për ndërprerjen e mardhënies së punës duke pretenduar se është i sigurt 100% se këtë vendim nuk e kishte parë asnjehere më parë,të cilin ja kishte prezentuar gjyqtari i çështjes gjatë seancës e datës 31.05.2016,ndërsa gjykata ka vërtetuar se për paditesin në fjalë është lëshuar aktvendimi për ndërprerjen e mardhënies së punës nr.04-252 të datës 14.03.2013, e lëshuar nga Komuna e Novobërdës,ku këtë e ka pohuar edhe përfaqesuesi i tij se aktvendimin mbi ndërprerjen e mardhënies së punës ja ka sjell vet paditësi,dhe gjykata konstaton se deklarata e paditësit nuk e është e besueshme për të drejtën e tij subjektive, ngase i njëjti nuk ka paraqitur dëshmi të besueshme lidhur me ndërprerjen e mardhënies së punës .

5.1.2. Deri te ky konstatim gjyqtari erdhi duke u bazuar në provat personale dhe materiale në shkresat e lëndës e të cilat nuk vërtetuan gjendjen ekzistuese faktike sikurse paditësi i ka paraqitur në padi, me ç,rast konstatoi e njëjta nuk ka pësuar asnjë dëm material nga e paditura, fakt ky që u vërtetua nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësorë.

Gjykata vendosi që paditësin ta obligoj ta paguaj shumën prej 40 € (pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi),konform Udhëzimit Administrativ Nr.2008-02 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, dhe atë për pagimin e taksës gjyqësore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marr në pajtim me nenin143 dhe 450 të LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, e bazuar në nenin 132 , 155 dhe 185 të LMD-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.43/14, më datë 03.06.2016

Gjyqtari
Venhar Salihu

Këshilla juridike : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykim, ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate .

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Dega në Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Venhar Salihu, me bashkëpunëtorin profesionalë Vlora Selmani – Rahimi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore me objekt kontesti kompenzimi i pagave, sipas padisë së paditësit Hrnsillav Jovanoviq nga fshati Koretishtë , Komuna e Novobërdës, të cilin e përfaqëson, av. Vehbi Ismajli, kundër të paditurit Komuna e Novobërdës, në seancën gjyqësore dhe publike të datës 03.06.2016 , mori dhe shpalli, këtë :

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit Hrnsillav Jovanoviq nga fshati Koretishtë, Komuna e Novobërdës, e ushtruar ndaj të paditurit Drejtora Komunale Arsimit në Novobërdë, me të cilën ka kërkuar që të të detyrohet i padituri ti ja kompenzoj dëmin material, në vlerë prej 7,900.55€, me kamatë ligjore 8%, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 779.00Euro.
- II. OBLIGOHET** paditësi Hrnsillav Jovanoviq që kësaj gjykate në emër të taksës gjyqësore t'ia paguajë shumën prej 40 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Secila palë i përballon shpenzimet e saj të procedurës.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

Paditësi, Hrnsillav Jovanoviq nga fshati Koretishtë, Komuna e Novobërdës më datë 23.10.2013, ka ushtruar padi për kthim në vendin e punës dhe kompenzimin e të ardhurave personale , kundër të paditues Drejtora Komunale Arsimit në Novobërdë , dhe ka kërkuar që të obligohet e paditura e lartpërmendur me të cilën ka kërkuar që e paditura të detyrohet i padituri ti ja kompenzoj dëmin material, në vlerë prej 7,900.55€, me kamatë ligjore 8% sipas LMD, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 779.00Euro.

1.1.1. Pas pranimit të padisë , kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur iu ka dërguar padinë, në mënyrë që e njëjta të paraqesë përgjigje lidhur me pretendimet e saj, njëkohësisht duke e paralajmëruar të paditurën, që nëse brenda afatit të paraparë ligjor nuk përgjigjet gjykata do të merr aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë- mosbindjes, të cilën paditësi e ka kundërshtuar në tërësi.

2. Juridiksioni dhe kompetenca e gjykatës

2.1. Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështje dhe bazuar në nenin 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), por edhe me dispozitat ligjit mbi marrëdhëniet detyrimore (LMD), konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin civil dhe kjo gjykatë është kompetente për të vendosur.

2.1.2. Lidhur me kompetencën territoriale në pajtim me nenin 37.1 dhe 38.1 të LPK-së, për procedimin e çështjes, është kompetente gjykata e kompetencës së përgjithshme, ku i padituri ka vendbanimin, ndërsa në pajtim me nenin 47.1 Për gjykim në kontestet lidhur me përgjegjësinë jokontraktuale për demin, përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilës është kryer veprimi dëmtues apo gjykata në territorin e së cilës ka lindur pasoja e dëmtimit. Prandaj, pasi në rastin konkret i padituri ka vendbanimin në territorin e Komunes së Novobërdës dhe pasoja e dëmtimit sipas padisë ka lindur në Novobërdë , e kompetencës territoriale për të gjykuar këtë çështje është kjo gjykatë.

2.1.3. Lidhur me kompetencën lëndore në bazë të nenit 17.2 të LPK-së, vlerësimi i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura gjykata, meqenëse jemi para një kontesti me karakter civil që rrjedh nga marrëdhëniet jo kontraktuale, gjykata çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e çështjes.

3. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

3.1. Në seancën përgaditore, kryesore, si dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit av. Vehbi Ismjali, ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë përkatisht pranë ndryshimit të kërkesepadise të bërë në seancën gjyqësore të bërë në seancën e datës 03.06.2016.

I autorizuari Flamur Uka i të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit në Novobërdë, në seancën e shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se paditësi është larguar nga puna në bazë të rregulloreve në fuqi , përkatisht për shkak të skadimit të kontratës , dhe i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë paditësit ta refuzoj si të pa bazuar .

Paditësi Hrnislav Jovanović në seancën e datës 31.05.2016 ka deklaruar, se kontratën e punës e ka në shtëpi , por të njëjtën nuk po mundet ta gjej , dhe se ka bërë përpjekje në DKA në Gjilan , që ta siguroj përmes kërkesës zyrtare mirëpo nuk ka marr kurrfarë përgjigje , ndërsa sa

i përket vendimit për ndërprerjen e mardhënies së punës, është hera e pare që e shoh vendimin e tillë , duke pretenduar se është i sigurt 100% se këtë vendim nuk e kishte parë

Ndërsa sa i përket padisë të paraqitur nga i autorizuari i paditësit se paditësi nuk e ka marr kompenzimin e pagave , ne senacen e dates 15.04.2016 ka deklaruar se paditësi figuron figuron ne listen e pagave edhe pse nuk ka kontratë pune .

4.Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

4.1. Gjykata ka lexuar - dhe administruar këto prova:

-Leximin e aktvendimit për ndërprerjen e mardhënies së punës nr.04-252të dt .14.03.2013, e lëshuar nga Komuna e Novobërdës,

-Leximin e ankesës të datës 11.06.2014, nga paditësi Hrnislav Jovanoviq, drejtuar Komunës së Novobërdës,

-Leximin e ankesës të datës 12.08.2014, nga paditësi Hrnislav Jovanoviq, drejtuar Komunës së Novobërdës,

-Leximin e kopjes së listës së pagave të lëshuara nga Buxheti i Rep. së Kososvës ,

-Leximin e pasqyrës së lëshuar nga Trusti Pensional , për periudhën kohore të datës 01.08.2002, gjer me datën 02.10.2013 , të paditësit Hrnislav Jovanoviq , (6 faqe kopje),

-Leximin e njoftimit të datës 06.05.2014, e lëshuar nga Drejtoria e Arsimit në Novobërdë ,

-Leximin e përgjegjës nr.04-670,të dt .09.09.2014 e lëshuar nga Drejtoria e Arsimit në Novobërdë,

-Leximin e marrëveshjes së mirëkuptimit nr.08.02.2009 , e datës 11.01.2011 , e lidhur në mes të Komunës së Gjilanit dhe Komunës së Novobërdës .

4.2 Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, nga të cilat ka gjetur se kërkesë padia është e pa bazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet.

5.Vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatës

*Nga dëgjimi i palëve ndërgjyqëse , gjykata vërtetoi faktin se në bazë të Ligjit të Punës nr .03 L-212 , i cili ka hyrë në fuqi me **16.12.2010** , përcakton se ne rastin konkret gjykata ka vlerësuar se padia e paditësit është paraqitur pas afatit ligjor të paraparë me nenin 79 te Ligjit te punës ku thuhet se „çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente,,e që paditësi ne rastin konkret ankesë kundër aktvendimit nr.04-252 te datës 14.03.2013 , nuk ka paraqitur ankesë por ankesen e ka parqitur përfaqesuesi i tij me datë 11.06.2014 , si dhe me datë 12.08.2014 , e qka mund të vërtetohet se ankesa e ka paraqitur me date 12.08.2014,ndërsa padinë e paditesit ne gjykatë*

e ka paraqitur me date 22.10.2014 , qka nënkuptojmë se nuk është paraqitur padia ne afatin e lejuar ligjor për mbrojtjen gjyqësore të punësuarit.

5.2. Nga provat tjera materiale janë shtjelluar edhe arsyetimet e paditësit sa i përket vendimit për ndërprerjen e mardhënies së punës, se është hera e pare e tij që e sheh vendimin e tillë,për ndërprerjen e mardhënies së punës duke pretenduar se është i sigurt 100% se këtë vendim nuk e kishte parë asnjehere më parë,të cilin ja kishte prezentuar gjyqtari i çështjes gjatë seancës e datës 31.05.2016,ndërsa gjykata ka vërtetuar se për paditesin në fjalë është lëshuar aktvendimi për ndërprerjen e mardhënies së punës nr.04-252 të datës 14.03.2013, e lëshuar nga Komuna e Novobërdës,ku këtë e ka pohuar edhe përfaqesuesi i tij se aktvendimin mbi ndërprerjen e mardhënies së punës ja ka sjell vet paditësi,dhe gjykata konstaton se deklarata e paditësit nuk e është e besueshme për të drejtën e tij subjektive, ngase i njëjti nuk ka paraqitur dëshmi të besueshme lidhur me ndërprerjen e mardhënies së punës .

5.1.2. Deri te ky konstatim gjyqtari erdhi duke u bazuar në provat personale dhe materiale në shkresat e lëndës e të cilat nuk vërtetuan gjendjen ekzistuese faktike sikurse paditësi i ka paraqitur në padi, me ç,rast konstatoi e njëjta nuk ka pësuar asnjë dëm material nga e paditura, fakt ky që u vërtetua nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësorë.

Gjykata vendosi që paditësin ta obligoj ta paguaj shumën prej 40 € (pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi),konform Udhëzimit Administrativ Nr.2008-02 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, dhe atë për pagimin e taksës gjyqësore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marr në pajtim me nenin143 dhe 450 të LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, e bazuar në nenin 132 , 155 dhe 185 të LMD-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.43/14, më datë 03.06.2016

Gjyqtari
Venhar Salihu

Këshilla juridike : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykim, ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate .

C.nr.14/2013

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Dega në Novobërdë, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Leonora Shemsiu-Kadriu, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore me objekt kontesti kompenzimi i dëmit, sipas padisë së paditëses Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson, Nazmije Aliu, dhe të paditurit Srgjan Jovanoviq, nga fshati Stanishor, në seancën gjyqësore dhe publike të datës 17.12.2015, mori dhe shpalli, këtë :

A K T G J Y K I M

- III. REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesëpapia e paditëses Dogana e Kosovës, e ushtruar ndaj të paditurit *Sergjan Jovanoviq*, nga fshati *Stanishor*, Komuna e *Novëbërdës* me të cilën ka kërkuar që të të detyrohet i padituri ti ja kompenzoj dëmin material, në vlerë prej *1.766.40€*, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës deri në përfundimin e kontestit.
- IV. OBLIGOHET** paditësja Dogana e Kosovës që kësaj gjykate në emër të taksës gjyqësore t'ia paguajë shumën prej *40 €*, në afat prej *15 ditësh* pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Secila palë i përballon shpenzimet e saj të procedurës.

A r s y e t i m

1.Rrjedha e çështjes

*Paditësja Dogana e Kosovës, -Prishtinë, më datë 13.10.2009, në Gjykatën Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm(ish Gjykata Komunale), ka ushtruar padi për kompensimin e dëmit, kundër të padituri Srgjan Jovanoviq, nga fshati Stanishor, dhe ka kërkuar që të obligohet e paditura e lartpërmendur që paditëses Doganës së Kosovës, t'ia kompensojë dëmin material në shumën *1.766.40 euro*, me kamatë ligjore dhe shpenzimet e procedurës deri në përfundim të kontestit, në afat prej *15 ditësh*, për shkak se i padituri me rastin e regjistrimit të automjetit të tipit "VË Golf 1HXO", me ngjyrë hiri, nr. të shasisë *ËVËZZZ1HZRË336791*, viti i prodhimit *1994*, në qendrën e regjistrimit të automjeteve në *Graçanicë*, me qëllim të ikjes së obligimit të pagesës së taksave doganore ka fshehur faktet dhe ka vënë në lajthim qendrën e regjistrimit të automjeteve në *Graçanicë*, duke i prezantuar dokumentet e falsifikuara, me çrast edhe e ka regjistruar veturën pa e bërë pagesën e obligimeve doganore me çrast i ka shkaktuar dëm Doganës së Kosovës- buxhetit të konsoliduar të Kosovës në vlerë *1.766.40 euro*, duke paraqitur si dëshmi edhe aktgjykimin e e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P.nr.1306/06 të datës *14.07.2009*.*

1.1.1.Pas pranimit të padisë, kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur iu ka dërguar padinë, në mënyrë që e njëjta të paraqesë përgjigje lidhur me pretendimet e saj, njëkohësisht duke e paralajmëruar të paditurin, që nëse brenda afatit të paraparë ligjor nuk përgjigjet gjykata do të merr aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë- mosbindjes, të cilën paditësi e ka kundërshtuar në tërësi.

Në seancën përgatitore dhe atë kryesore, përfaqësuesja e autorizuar e Doganës së Kosovës, Nazmije Aliu, në tërësi ka mbetur pranë kërkesë padisë duke kërkuar nga gjykatata që të paditurin ta obligojë për pagesën e demit material në vlerë 1.766.40 euro, si dhe kërkesat aksesore sipas padisë, ndërsa i padituri në tërësi e ka kundërshtuar të njëjtën, duke i prezantuar gjykatës dëshminë për pagesën e dënimit të shqiptuar nga aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Prishtinë, njëkohësisht ka deklaruar se automjetin për të cilën paditësja kërkon pagesën e demit material e ka shitur, dhe doganën të njëjtit ia ka paguar, me këtë rast ka kërkuar nga Gjykatata që në rrugë zyrtare të kërkojë dëshminë për pagesën e doganës.

Gjykatata Themelore në Gjilan, me kërkesën C.nr.14/203 të dates 09.10.2015, i është drejtuar Doganës së Kosovës që të njoftojë nëse automjetit të lartpërmendur i është paguar dogana.

2. Juridiksioni dhe kompetenca e gjykatës

2.1. Fillimisht, gjykatata shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështje dhe bazuar në nenin 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), por edhe me dispozitat ligjit mbi marrëdhëniet detyrimore (LMD), konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin civil dhe kjo gjykatë është kompetente për të vendosur.

2.1.2. Lidhur me kompetencën territoriale në pajtim me nenin 37.1 dhe 38.1 të LPK-së, për procedimin e çështjes, është kompetente gjykatata e kompetencës së përgjithshme, ku i padituri ka vendbanimin, ndërsa në pajtim me nenin 47.1 Për gjykim në kontestet lidhur me përgjegjësinë jokontraktuale për demin, përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, është kompetente edhe gjykatata në territorin e së cilës është kryer veprimi dëmtues apo gjykatata në territorin e së cilës ka lindur pasoja e dëmtimit. Prandaj, pasi në rastin konkret i padituri ka vendbanimin në territorin e Gjilanit dhe pasoja e dëmtimit sipas padisë ka lindur në Gjilan, e kompetencës territoriale për të gjykuar këtë çështje është kjo gjykatë.

2.1.3. Lidhur me kompetencën lëndore në bazë të nenit 17.2 të LPK-së, vlerësimi i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura gjykatata, meqenëse jemi para një kontesti me karakter civil që rrjedh nga marrëdhëniet jo kontraktuale, gjykatata çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e çështjes.

3. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

3.1. Përfaqësuesja e paditëses- Dogana e Kosovës- Prishtinë, Nazmije Aliu, në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se megjithëse ka pranuar përgjigjen nga Dogana e Kosovës lidhur me automjetin objekt i padisë, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë duke i propozuar gjykatës që të aprovojë të njëjtën si të bazuar dhe ta obligojë të paditurin, ta kompensojë demin doganor në vlerë 1.766.40 euro, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës deri në përfundimin e kontestit në afat prej 15 ditësh nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

I padituri Srgjan Jovanoviq në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 17.12.2015, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses me arsyetimi se një kërkesë e tillë është e paarsyeshme, meqenëse për të njëjtin veprim është përgjigjur penalisht sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, sipas të cilit aktgjykim edhe e ka paguar dënimin e shqiptuar në shumën 300 euro e po ashtu ka pranuar njoftimin nga Dogana e Kosovës sipas të cilit është paguar dogana e veturës në fjalë nga mbajtësi i veturës dhe se gjatë kësaj procedure është vërtetuar se Republikës së Kosovës nuk i është shkaktuar asnjë dëm nga ky veprim ndërsa si prova materiale i ka propozuar gjykatës të shtjellohen provat në shkresa të lëndës.

4.Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

4.1. Gjykata ka lexuar- dhe administruar këto prova:

- aktgjykimi i Gjykatës Komonale në Prishtinë, P.nr.1306/07 i datës 14.07.2009,
- ankesa e datës 28.10.2009 e paraqitur nga i padituri,
- autorizimi datës 25.06.2015. i lëshuar nga Republika e Kosovës-Ministria e Drejtësisë, me të cilin është autorizuar Nazmije Aliu që të përfaqësojë të paditësen,
- kërkesa e datës 09.10.2015, drejtuar Doganës së Kosovës në Prishtinë , në lidhje me doganimin e veturës VË Golf IHXO, me nr. të shasisë ËVËZZZ1HZRË336791, viti i prodhimit 1994(e ushtruar nga gjyqtari paraprak i lëndës) ,
- Përgjigja e Ministrisë së Financave- Dogana e Kosovës e datës 15.10.2015 me të cilën e ka njoftuar gjykatën lidhur me kërkesën,
- kërkesa e datës 09.10.2015, drejtuar Qendrës Komonale për Regjistrimin e Automjeteve në Prishtinë,
- Përgjigja e Ministrisë së Punëve të Brendshme-Drejtorisë për Regjistrimin e Automjeteve e datës 22.10.2015,
- fletëpagesa e Bankës për Biznes e datës 17.05.2011.

4.2 Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjygjëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, nga të cilat ka gjetur se kërkesë padia është e pa bazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet duke vërtetuar këtë gjendje faktike.

5.Vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatës

5.1. Se i padituri Srgjan Jovanoviq nga fshati Stanishor, për shkak të shmangies nga obligimi i pagesës së doganës dhe akcizës është dënuar për shkak të veprës penale të mashtrimt me aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Prishtinë është fakt i pakontestueshëm nga kjo gjykatë meqenëse kjo u vërtetua me aktgjykimin P.nr.1306/07 të datës 14.07.2009, sipas të cilit rezulton se i njëjti e ka shlyer detyrimin ligjor nga kjo vepër penale, sipas fletëpagesës së Bankës për Biznes të datës 17.005.2011, fletëdeponimi 1300-0051-000001.28. Mirëpo për gjykatën ishte kontestues obligimi që rrjedh sipas padisë meqenëse i njëjti nga përfaqësuesi i Doganës së

Kosovës ishte në kundërshtim me njoftimin e Doganës për dëmin e shkaktuar, prandaj në mungesë të dëmit kjo gjykatë e refuzoi kërkesë padinë e paditësit si të pabazuar.

5.1.2. Deri te ky konstatim gjyqtari erdhi duke u bazuar në provat personale dhe materiale në shkresat e lëndës e të cilat nuk vërtetuan gjendjen ekzistuese faktike sikurse paditësja i ka paraqitur në padi, me çrast konstatoi e njëjta nuk ka pësuar asnjë dëm nga i padituri, fakt ky që u vërtetua nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor

5.2. Nga provat materiale: Përgjigja e Ministrisë së Financave- Dogana e Kosovës e datës 15.10.2015 , me të cilën e ka njoftuar gjykatën lidhur me kërkesën nëse automjetit të tipit ‘‘VË Golf IHXO’’, me ngjyrë hiri, nr. të shasisë ËVËZZZ1HZRË336791, viti i prodhimit 1994, I është paguar dogana , rezultoi se automjetit për të cilin janë kërkuar të dhënat I është paguar dogana më date 04.02.2005 nga Rifat Sylejmani, prandaj në rastin konkret pa marrë parasysh faktin se nga kush është paguar dogana, paditësja nuk ka pësuar dëmin për të cilin kërkon kompenzimin.

5.2.1. Nga përgjigja e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës/Drejtorati për Regjistrimin e Automjeteve, Lista e Distribuimit, e dates 23.10.2015, nr.02/497, rezultoi se vetura e markës VË, modeli Golf IHXO, I vitit të prodhimit 1994, me nr. identifikues ËVËZZZ1HZRË336791, është regjistruar për here të pare në Qendrën e Regjistrimit të Graçanicës më date 23.11.2004 dhe dosja e këtij automjeti është marrë nga Policia e Kosovës më date 09.02.2006.

5.3.Në këtë kontekst, sipas Ligjit mbi Marëdhëniet Detyrimore, neni 155, ‘‘dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshem) dhe parandalimi i shtimit të tyre (përfitimi i munguar), ...’’, ndërsa në pajtim me nenin 185 paragrafi 1 e 2 , ‘‘personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkactohej dëmi, ndërsa në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë kompensim në të holla’’, prandaj edhe qëllimi i shpërblimit të dëmit material është mënjanimi, përkatësisht riparimi i demit, nga edhe pasojnë dy rregulla të rëndësishme : nuk ka shpërblim të dëmit, nëse nuk ka dëm dhe se shpërblimi nuk mund të jetë më i madh se dëmi. Përderisa në rastin konkret nuk është pësuar dëm nuk mund të ketë as shpërblim të demit pasi nga njoftimi i Doganës së Kosovës rezultoi se për veturën e markës VË, modeli Golf IHXO, i vitit të prodhimit 1994, me nr. identifikues ËVËZZZ1HZRË336791, është paguar dogana dhe akciza në vitin 2005 dhe në këtë kontekst as nuk kemi dëm të shkaktuar, pasi tek paditësja është kthyer gjendja ekzistuese para shkaktimit të dëmit dhe si e tillë kërkespadija është e pabazuar sepse në këtë rast do të konsiderohet si pasurim i paditëses , pavarësisht se në rastin konkret kemi një aktgjykim penal sipas të cilit i padituri është shpallur fajtor

6.Dispozitat ligjore të aplikueshme

6.1. Duke u nisur nga parimi kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, sipas së cilit rrjedhin edhe bazat e

përgjegjësisë, e po ashtu duke u mbështetur në nenin 132 të LMD-së¹, sipas të cilit “secila palë ka detyrime ndaj palës tjetër për dobitë që ka pasur në ndërkohë prej asaj që e ka për detyrë ta kthejë ose ta shpërblejë“, dhe në rastin konkret detyrimet ndaj paditëses, sipas provave të shtjelluara janë përmbushur në tërësi pasi për veturën e lartëpërmendur është paguar dogana dhe akciza, ndërsa sa i përket kompensimit të dëmit të kërkuar në kërkesë padi u refruzua për shkak se nuk mund të jetë pasurim i saj, prandaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi që paditësen ta obligoj ta paguaj shumën prej 40 € (pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi), konform Udhëzimit Administrativ Nr.2008-02 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, dhe atë për pagimin e taksës gjyqësore për dorëyimin e padisë shumën prej 20 €, si dhe për përpilimin e këtij aktgjykimi shumën prej 20 €.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marr në pajtim me nenin 143 dhe 450 të LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, e bazuar në nenin 132 , 155 dhe 185 të LMD-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.14/13, më datë 24.01.2017

Gjyqtarja,
Mevlide Shabani

Këshilla juridike : *Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykim, ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate .*

¹ Meqenëse marrëdhënia juridike kontraktuale ka lindur në kohën kur ka qenë i zbatueshëm Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, të RSFJ-së, i vitit 1978, aktgjykimi është marrë në bazë të këtyre dispozitave, por pasi procedura gjyqësore është zhvilluar tani, e njëjta është zhvilluar bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit të Procedurës Kontestimore të vitit 2008.